**ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT**

*Sipas Nenit 109 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës se Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092*

Një ankesë kundër: **ADMINISTRATA E QENDRËS - MINISTRIA E FINANCAVE,PUNËS DHE TRANSFEREVE**

Për Aktivitetin e Prokurimit Nr. i AP: **201.-22-14626-2-2-1**

Sa i përket tenderit për **Shërbimet e Sigurimit fizik të objektve të ish MPMS-se**

# ANKESË

## 1. Identifikimi i ankuesit*

| | |
|---|---|
| Shëno emrin e plotë të kompanisë suaj | **"Internat Security Association"SH.P.K.** |
| NUI | **601073042** |
| Adresa | **Mustafë Kruja nr.3** |
| Vendi | **PRISHTINË** |
| Kodi postar | **10000** |
| Numri Telefonit | **049778877** |
| Emri i plotë i përfaqësuesit të kompanisë suaj | **Fitim Gashi** |
| Adresa elektronike | **info@securityisa.org** |
| Data e parashtrimit të ankesës | **09.08.2023** |

**Ankues do të thotë një palë e interesuar për parashtrim të ankesës.*

## 2. Identifikimi i avokatit

*Parashtruesi i ankesës mund ta parashtroj ankesën vetëm ose përmes avokatit të tij. Nëse ankesa parashtrohet përmes avokatit, atëherë duhet bashkangjitur autorizimin e përfaqësimit me PROKURË.*

*Shëno të dhënat si në vijim:*

Emri i avokatit

Adresa e plotë

Numri i Telefonit

Numri i faks-it

Adresa elektronike

## 3. Të dhënat mbi aktivitetin e prokurimit

*Shëno një përshkrim te shkurtër lidhur me datën dhe vendin në të cilën është publikuar " Njoftimi për Kontratë" apo "Njoftimi për konkurs te projektimit" dhe, nëse aplikohet "Njoftimi për dhënie të Kontratës" "Njoftimi për Rezultatet e Konkursit të Projektimit", apo "Njoftimi për anulim te aktivitetit te prokurimit", nëse aplikohet, afatin e fundit për dorëzimin e tenderit, datën dhe orën e fillimit të procesit për Hapjen e Tenderëve, si dhe kriteri për dhënie të kontratës:*

Ankesa i përket grupeve:

**Shërbimet e Sigurimit fizik të objektve të ish MPMS-se**

**Njoftimi per kontrate i dt.27.12.2023, data e rivlersimit te tenderit.**

## 4. Procesi i Hapjes së tenderëve, *nëse aplikohet*

*A keni marrë pjesë në procesin e Hapjes së tenderëve? Nëse po, specifikoni shkurtimisht ecurinë e procesit të Hapjes së Tenderëve.*

**Po** ☐ **Jo** ☒

## 5. Njoftimi mbi Eliminimin e Tenderuesve, *nëse aplikohet*

*A jeni njoftuar me shkrim lidhur me eliminimin tuaj nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në aktivitetin e prokurimit ?*

***Po*** ☐ ***Jo*** ☒

## *6. Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve*

*A keni bërë kërkese për rishqyrtim pranë AK lidhur me arsyet e eliminimit tuaj?*

**Po** ☒ **Jo** ☐

*Nëse po, ofroni detaje mbi këtë fakt dhe bashkëngjit një kopje te vendimit te miratuar nga AK gjate kontestit paraprak te zgjidhjes se mosmarrëveshjeve ne përputhje me nenin 108A te LPP-se.*

**Vendimi per rishqyrtimin i dt.02.08.2023**

## 7. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

*Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs te Projektimit, dhe nëse aplikohet gjerë në përmbylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njoftimit për Dhënien e Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.*

Neni 7
Neni 59
Neni 60
Neni 61

Duke pas parasysh se ne si OE pjesmarrës në këtë AP kemi ofertuar duke e plotësuar kërkesën e dosjes së tenderit e cila ka qenë ë kërkuar që të plotësohët me deklarim përmes një deklarate të cilën ne e kemi në dosjen e tenderit ku thuhet se OE duhet të deklaroj me shkrim se do ti përmbahet kërkesës për pagën minimale dhe respektohet në tërësi ligjet e aplikueshme në Republikën e Kosovës, e poashtu të paguhen edhe shtesat e punës së natës vikendeve dhe festive mbi pagën 200 euro netto.

**"Shënim: Paga NETO mujore për një roje nga ofruesi i sherbimeve kërkohet të jetë së paku 200 € për një muaj. Nga operatori ekonomik kërkohet që të dorëzoj një deklaratë origjinale të vulosur dhe të nënshkruar se do të respektojë pagën NETO mujore për një roje. Deklarata dorëzohet para nënshkrimit të kontratës, po ashtu kërkohet të respektohen ligjet e aplikueshme në Republikën e Kosovës. Për punëtorët që punojnë edhe me ndërrime duhet t'i paguhen shtesat për punë të natës, vikendeve dhe festave, mbi pagën prej 200.00€."**

Gjatë kalkulimit të ofertës sonë ne kemi kalkuluar të gjitha kërkesat e AK të cilat mund ti dëshmojmë edhe me një analizë financiare të cilën ne e kemi futur në dosjen e ofertuar në detalje se si kemi ardh deri te cmimi.

Nëse analizohet mirë analiza financiare e jona ju do të shifni se ne kemi kalkuluar edhe orët shtesë të kërkuara e poashtu edhe pushimet vjetore, gjë të cilën nuk e kanë bërë kompanitë tjera pjesmarrëse, kjo lën një hapësirë që të manipulohet me të drejta e dala nga ligji i punës të Republikës së Kosovës kundrejt punëtorëve të sigurimit e qka është më e keqja nëj gëj të tillë po e lejojnë si AK e poashtu edhe OSHP gjatë vlerësimit të ankesave të cilat po I bëjmë ne si OE duke u munduar që të mbulojmë të gjitha obligimet e dala nga po këto kërkesa të parashtruara nga AK.

Ne për këtë po e bashkëngjesim edhe analizën tonë financiare për ju që të analizoni atë dhe njëkohësisht ta vlersoni si të bazuar dhe ta ktheni lëndën në rivlersim duke na dhënë të drejtën tonë për të mbrojtur si kompaninë e poashtu edhe punëtorët tëcilët kryejnë shërbimet për OE dhe natyrisht se kërkojnë të drejtën e tyre për tu paguar në harmoni me ligjin dhe për të shfrytëzuar edhe të drejtën e tyre për shfrytëzimin e pushimeve sipas ligjit, njëkohësisht edhe duke respektuar orarin e punës prej 8 orësh sipas kërkesës së AK.

Vlen të ceket se kjo kontratë më parë është realizuar në po të njejtën kohë me institucione të ndara nga ky AP, për shpjeguar më mirë ne po ju bashkëngjesim edhe vendimin e OSHP për institucionet të cilat ishin në një AP me vendorjet për të cilat ne kemi ofertuar përmes një AP tjetër dhe OSHP ka vlerësuar në mënyrë të duhur AP duke lëshuar një vendim I cili anulon në tërësi AP, mu për këto shkaqe.

Është e pamundur se si disa OE manipulojnë me analiza finanicare dhe vënë në lajthitje AK duke e bërë që të duket se ata plotësojnë të gjitha kushtet mirëpo kur hyhet në detaje analiza shumë lehtë mund të dallojmë se kërkesat nuk janë plotësuar dhe se një gjë e tillë përbën shkelje ndaj të drejtave të punëtorëve dhe rrezikim që institucionet të mbesin pa punëtor sigurimi dhe siguria e objekteve të rrezikohet.

Në këtë AP është kërkuar që kushti i pagave të jetë 200 euro netto pagë dhe të llogariten edhe shtesat e tjera mbi pagën si orët e natës, orët e vikendeve dhe festave dhe të respektohet ligji i punës së Republikës së Kosovës, që do të thotë se automatikisht duhet të respektohet edhe e drejta e punëtorëve të sigurimit në projekt, gjë e cila përcaktohet me po të njejtin ligj shfrytëzimi i pushimeve vjetore, asnjëri prej OE nën cmimin e dhënë nga ne si OE pjesëmarrës në këtë AP, nuk është i përgjegjshëm pasi që nuk i ka kalkuluar në mënyrë të duhur këto kërkesa të cilat në analizat e tyre janë të mangëta dhe nuk janë kalkuluar si duhet.

Fakte dhe argumente:

Oe fitues në këtë AP, te oret e nates dhe oret e vikendeve e festave nuk i ka llogaritur si duhet dhe kjo eshte anashkaluar pa u vertetuar mire nga AK si Prsh:
Paga netto 200 euro /176 ore eshte fakt që është 1.14 euro për orë por kësaj shume kur i shtohet 30% e që është 1.48 euro mirëpo ky nuk mund të jetë cmim përfundimtar për llogaritjen e orëve të natës pasi që këtij cmimi duhet ti shtohen edhe kontributi nga punëdhënësi, kontributi nga punëmarrësi dhe tatimin në burim i pagës, andaj kjo është dashtë të evidentohet nga AK dhe të kërkohet shpjegim në lidhje me cmimin e dhënë pasi që ky kalkulim do ti shtonte vlerën cmimit përfundimtar të dhënë nga ky OE.
Shembull paga 200 netto kur i shtohen të gjitha shtesat arrijmë te vlera 226.58 euro ku janë të përfshira kontributet dhe tatimi në burim i pagës, dhe cmimi për orë pune i bie të jetë 1.29 dhe plus 30% e orëvë të natës 1.67 euro për orë, që do të thotë se diferenca mes cmimit është – 0.20 euro/cent.
Oret mesatare per një muaj të ndrrimit të natës janë 176 orë / 1/3 e këtyre orëvë orë nate 59 orë për një punëtor andaj cmimi i dhënë për orë nate në analizë prej 10 euro është i pa arsyeshëm, 59*0.34 euro =20.06 euro.
Ju lutem të keni parasysh këto cmime dhe shpjegimi sepse ky OE nuk është i përgjegjshëm në asnjë pozicion
Te orët e vikendeve minimum 48 orë duhet ti llogariten një punëtori në muaj dhe cmimi për orë pune shtesë mbi orën bazë është 1.14 euro 0.57 euro/cent andaj gjithsej ky cmim për orë vikende duhet të jetë 48*0.57=27.36 euro kurse ky OE ka dhënë një cmim prej 12 euro, duke mos hyrë më shumë në detaje ky kalkulim jep një rezultat se është manipuluar cmimi i OE për të ju dukur AK se është në rregull.
Poashtu edhe OE tjetri në radhë grupi i OE Skyfterat dhe Jaguar te orët e natës ka dhënë një kalkulim të gabuar viti i ka 365 ditë kur shumëzojmë me 8 orë jep rezultatin 2920/12 muaj 243 orë / 4 punëtor = 60 orë apo mesatare 59 orë siq kemi llogaritur edhe ne në një mënyrë më të thjeshtë apo ndoshta OE i është shkurtuar paksa viti. Apo ja edhe një shembull 30.5 ditë x 8 orë /4 punëtor prapë jep rezultatin 61 orë apo 59 orë mesatare mujore nate për një puntor me ndërrime në rrotacion.

Duke pas parasysh këto që u thanë më lartë ne mendojmë se të dy OE si veqmas ashtu edhe në grup janë të papërgjegjshëm financiarisht, andaj ne mendojmë se AK duhet të anulojë vendimin për dhënie kontrate dhe të kthejë lëndën në rivlersim duke kërkuar më të detajuar analizën financiare nga OE të lartëpërmendur në këtë kërkesë, dhe të kërkohet edhe plotësimi i kushtit të pushimeve vjetore dhe llogaritja e duhur e orëve shtesë. Për këtë ju lutem të angazhohet një eskpert shqyrtues i lëmis përkatëse, apo ekspert që ka dijeni në lidhje me kalkulimin e orëve shtesë.

Me respekt
International Security Association sh.p.k

*** Sipas Nenit 118 të LPP, OSHP-ja do të kthej tarifën tuaj nëse ankesa aprovohet si e bazuar. OSHP-ja mund të kërkoj një gjobë shtesë deri në 5,000 Euro në rastet kur OSHP-ja konstaton që të gjitha apo cilado nga pretendimet e parashtruara në ankesë kane qenë e rrejshme ose mashtruese.*

## 8. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

*Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuar për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të ankesës tuaj.*

## 9. Dëmet materiale

*Përshkruaj mënyrën se si shkelja e supozuar i ka shkaktuar ose kërcënohet t'i shkaktojë dëme materiale parashtruesit të ankesës, në rast se përfshini pretendime për kompensim.*

**Mundesia e Shperblimit em kontrate**

## 10. Lista e dokumenteve (dëshmive) të bashkangjitura

*Nëse aplikohet, bashkëngjitni Ankesës dokumentet e renditura më poshtë:*

*a) një kopje të publikimit të "Njoftimit për Kontratë" apo "Njoftimit për Konkurs të Projektimit.*
*b) një kopje të publikimit për "Njoftimin e Dhënies së Kontratës" apo "Njoftimin për Rezultatet e Konkursit të Projektimit" apo "Njoftimit për Anulim".*
*c) një kopje të letrës së eliminimit të tenderuesit/kandidatit/ letrës se tenderuesit të pasuksesshëm/ letrës për mos para-kualifikim.*
*d) një kopje të procesverbalit të hapjes publike të tenderëve, nëse aplikohet,*
*e) bashkëngjit një kopje te vendimit te miratuar nga AK gjate kontekstit paraprak te zgjidhjes se mosmarrëveshjeve ne përputhje me nenin 108A te LPP-se,*
*f) Dëshminë e pagesës së tarifës së ankimit në përputhje me nenin 118 të LPP-se, dhe*
*g) të gjitha korrespondencat e juaja me autoritetin kontraktues duke përfshirë e-mailat si dhe çdo informatë të shkruar që ka të bëjë me këtë aktivitet prokurimi, si dhe me secilin pretendim të paraqitur në ankesë.*

****Sipas Nenit 111.2 të LPP, Parashtruesi i ankesës, origjinalin e ankesës do t'ia dorëzojë OSHP-së dhe njëkohësisht një kopje do t'ia dërgojë në mënyrën më të shpejtë të mundshme Autoritetit Kontraktues.*